



NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë Shërbimi

Procedurë e hapur

Në përputhje me nenin 10, "Procedura e hapur" të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (dhjetor 2024)

Data e shpalljes: 27.01.2025

Nr. i Prokurimit: "BQK 25 002 221"

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK	
Adresa: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: +383 38 222 055/451	

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Shërbime të auditimit të procedurave të dakorduara"
Lloji i prokurimit: Shërbime për auditim periodik të procedurave të dakorduara, për minimum 5 vite paraprake.
Vendi kryesor i realizimit: Prishtinë
Informacione të marrëveshje afatgjatë: n/a
Variantet pranohen: Jo
Vlera e parashikuar e kontratës për shërbimin: 30,000.00 euro
Ndarja në Pjesë: Jo

III INFORMACIONE PËR SHERBIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjedhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale shërbime të auditimit të procedurave të dakorduara për një periudhë prej min 5 vitesh paraprake, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi dhe në harmoni me kërkesat ligjore që dalin nga Ligji 04/L-093 (“Ligji për bankat institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare). Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t’u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t’i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim. **Vëmendje për operatorët ekonomik që t’i kenë parasysh kërkesat sipas tabelës në vijim rreth vendosjes së evidencave/dëshmime në ofertat e tyre.**

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 kur aplikohet) janë të obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i>	Kërkesa 1: Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë. Evidenca 1: Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin përkatës i cili gjendet në dosjen e tenderit.
	Kërkesa 2: Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C. Evidenca 2: Sipas procedurës përkatëse e zbatimit me dy zarfe, zarfi me ofertën teknike dhe zarfi me ofertën financiare: 2.a) Formulari i tenderit që gjendet në dosjen e tenderit, Pjesa C (pjesa e parë ku nuk paraqitet çmimi) duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular, të nënshkruhet dhe vulozet. 2.b) Deklarata e ofertuesve tek Pjesa C, (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen, të nënshkruhet dhe vulozet.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në Kërkesat 1, 2 dhe 3 të kësaj tablele.

¹ Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

	<p>Kërkesa 3: Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)</p> <p>Evidenca 3: Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohet si të tilla. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë.</p> <p>Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të Rregullës për Prokurimin në BQK. Kurse kërkesat për kriteret e përzgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p>Kërkesa 4: Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p>Evidenca 4: Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p>Kërkesa 5: Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p>Evidenca 5: Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p>Kërkesa 6: Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p>Evidenca 6: Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>

	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6 të kësaj tablele.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Nuk aplikohen
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 7, 8, 9, 10 dhe 11) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime	<p><u>Kërkesa 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku tri kontrata te natyrës se ngjashme përgjatë 3 (tri) viteve të fundit (2022, 2023 dhe 202, përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontrate).</p> <p><u>Evidenca 7:</u> Ofertuesi duhet te ofroj si dëshmi: 7.a) certifikatat relevante te pranimit te shërbimit ose referencat qe evidentojnë realizimin e shërbimit të tillë, dhe 7.b) kopjet e kontratave përkatëse</p> <p><u>Kërkesa 8.</u> Ofertuesi duhet ta plotësoj formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><u>Evidenca 8.</u> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me informatat për shërbimet e ngjashme të realizuara ne tri vitet e fundit (2022, 2023 dhe 2024, përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontrate) duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumen e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej shërbimeve.</p> <p><u>Kërkesa 9:</u> Kryesi i shërbimit (ofertuesi) duhet të jetë auditor i jashtëm i pavarur.</p> <p><u>Evidenca 9:</u> Licenca e lëshuar nga institucioni përkatës i Republikës së Kosovës që dëshmon se kompania operon si firme ligjore e auditimit.</p> <p><u>Kërkesa 10:</u> Ekipi i përbërë/propozuar (i cili do të kryej punën) me përvojë specifike në auditim, çështje ligjore, të pajtueshmërisë, ose forenzikës.</p> <p><u>Evidenca 10:</u> Të dorëzohen CV-të apo dëshmi relevante, të cilat duhet të përfshijnë përvojën e anëtarëve të ekipit në auditim, çështje ligjore, pajtueshmërisë, ose forenzikës.</p> <p><u>Kërkesa 11:</u> Përvoja paraprake e ekipit të propozuar ose e kompanisë së auditimit në shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit në fushën e auditimit, çështjeve ligjore, pajtueshmërisë, ose forenzikës.</p> <p><u>Evidenca 11:</u> Të dorëzohen CV-të apo dëshmi relevante e ekipit të propozuar, të cilat duhet të përfshijnë përvojën e tyre ne kryerjen e shërbimeve , në fushën e auditimit, çështjeve ligjore, pajtueshmërisë, ose forenzikës.</p>

V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: “Procedurë e hapur”, sipas *Nenit 10 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (dhjetor 2024)*.

VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “*Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*”, në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK.

Kriteri	Pesha
1. Çmimi	25%
2. Oferta teknike	75%

VII INFORMATA ADMINISTRATIVE PËR OFERTUESIT

Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 04.02.2025, ora 12:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org .
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 04.02.2025, ora 14:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org .
Afati i fundit dhe vendi i dorëzimit të ofertave, data: 06.02.2025, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave, data: 06.02.2025, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Garibaldi” nr.33, Prishtinë.
Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): 1,000 euro (njëmijë/euro) me vlefshmëri 90 ditë nga data e hapjes të ofertës.
Kushti i sigurimit të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.
Periodha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertës.
Dokumentet me pagesë: Jo

VIII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org , brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuuese duhet të paguajë një
--

tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

IX. ADRESA

Rr. "Garibaldi" 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763